

KARTELË INFORMATIVE

AL011503

1. Emri i shërbimit	Kërkesë për transformim të regjistrimit ndërkombëtar në aplikim kombëtar			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Regjistrimi ndërkombëtar i një marke mund të transformohet në aplikim për markë kombëtare, sipas nenit 9quinques, të Protokollit të Madridit, si dhe sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në VKM Nr. 315, datë 31.05.2018 "Për miratimin e Rregullores për Markat".			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Nëpërmjet këtij aplikimi aplikantit i jepet mundësia të shpëtojë regjistrimin e markës së tij në një vend të caktuar, në rast se kjo markë është refuzuar në vendin e origjinës. Në rast se regjistrimi ndërkombëtar është anuluar, me kërkesë të Zyrës së Origjinës, sipas nenit 6 (4), përsa u përket të gjitha ose disa mallrave dhe shërbimeve listuar në regjistrin e përmendur, personi, i cili është mbajtës i regjistrimit ndërkombëtar, depoziton një aplikim për regjistrimin e të njëjtës markë pranë zyrës së çdo Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës regjistrimi ndërkombëtar ka efekt, që aplikimi do të jetë trajtuar sikur ai të jetë depozituar në datën e regjistrimit ndërkombëtar. Në qoftë se regjistrimi ndërkombëtar gëzon prioritet, do të gëzojë të njëjtin prioritet, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9quinques, të Protokollit të Madridit.			
4. A jam përfutues?	Individ, Person fizik apo juridik që ka një regjistrim ndërkombëtar të markës.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formulari për transformimin e një marke ndërkombëtare në aplikim kombëtar	Aplikanti / Institucioni	Po
	2	Dokumenti që vërteton se aplikimi ndërkombëtar është anuluar nga OBIP-ja, bazuar në kërkesën e zyrës së origjinës	Autoriteti i huaj	Po
	3	Mandatpagesa e tarifës përkatëse	Banka	Po
	4	Autorizim përfaqësimi	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	7 000 lekë	Komisioni bankar		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Në varësi të procesit të ekzaminimit, koha e përfundimit të procedurës zgjat 6-7 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit.			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	10 vjet			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E- albania:e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; Ligji Nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"; VKM Nr. 315, datë 31.05.2018 "Për miratimin e Rregullores për Markat"; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar; Protokolli i Marrëveshjes së Madridit për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare.			